



**International
Finance Corporation**
World Bank Group



THE WORLD BANK

Në Uashington, D.C.:

Nadine Ghannam
Telefon: +1 202 473 3011
E-mail: NSghannam@ifc.org

Në Beograd:

Slobodan Brkic
Telefon: +381 11 3023 750
E-mail: SBrkic@ifc.org

Në Vjenë:

Oliver William Griffith
Telefon: +33 1 4069 3195
E-mail: OGriffith@ifc.org

Evropa Juglindore vazhdon të përmirësojë Rregullat për Biznesin për sipërmarrësit deklarojnë Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC)-Banka Botërore

Vjenë, Austri, 28 qershor 2011- Sipas një raporti të ri të Korporatës Financiare Ndërkombëtare dhe Bankës Botërore reforma rregullatore e biznesit në Evropën Juglindore po u kursen sipërmarrësve vendas si kohën ashtu edhe paratë. Raporti i prezantuar sot *Të bësh biznes në Evropën Juglindore 2011 (Doing Business in Southeast Europe 2011)* është i dyti i këtij lloji që analizon se sa lehtë është të bësh biznes në 22 qytete nga shtatë ekonomi: Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kosovë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Moldavi, Malin e Zi dhe Serbi.

Ekonomitë e Evropës Juglindore kanë vazhduar reformën rregullatore për bizneset pavarësisht krizës financiare globale. Rezultatet tregojnë se të gjitha 19 qytetet e vlerësuara në raportin e vitit 2008 janë përmirësuar në të paktën një prej katër fushave rregullatore të vlerësuara – hapja e biznesit, marrja e lejeve të ndërtimit, regjistrimi i pronës dhe zbatimi i kontratave. Në të gjithë rajonin kostoja mesatare për të nisur një biznes është ulur nga 22 në 13 përqind të të ardhurave mesatare për frymë. Koha mesatare që nevojitet për të përpunuar lejet e ndërtimit dhe për të regjistruar pronën është reduktuar me më shumë se një muaj.

Ndërsa asnjëri prej qyteteve nuk ka rezultate të mira në të katër indikatorët e matur, në rajon është më lehtë të marrësh lejet e ndërtimit në Niksic (Mali i Zi) dhe të transferosh pronën në Balti dhe Kishinau (Moldavi). Shkupi (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) dhe Banja Luka (Bosnje-Hercegovinë) kanë bërë progresin më të madh duke realizuar reforma në fushën e biznesit në të katër fushat e vlerësuara. Nga ana tjetër është më e vështirë të nisësh një biznes në Prishtinë (Kosovë), të regjistrohësh pronën në Mostar (Bosnje-Hercegovinë) dhe të zbatosh një kontratë në Prizren (Kosovë). Marrja e lejeve të ndërtimit është më e vështirë në Beograd (Serbi).

Në disa kategori qytetet e rajonit mund të krahasohen me qytetet që kanë indikatorët më të mirë në botë. Duke aplikuar zgjidhjen “one stop shop” Shkupi (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) ka thjeshtuar procesin e hapjes së një biznesi duke zënë kështu vendin e pestë në botë në këtë fushë. Kompjuterizimi dhe ndërmjetësimi në mosmarrëveshjet tregtare kanë rritur efikasitetin e gjykatës në Zrenjanin (Serbi) ku zbatimi i kontratave tani është po aq i shpejtë sa në Shtetet e Bashkuara.

“Ekonomitë konkurruese nuk mund të mbijetojnë si ishuj”- tha Augusto Lopez Claros, Drejtor për Indikatorët dhe Analizën Globale në Grupin e Bankës Botërore. “Ndarja e përvojave për reformat është një mundësi për të përmirësuar konkurrencën në nivel kombëtar dhe rajonal”.

Të bësh biznes në Evropën Juglindore 2011 shqyrton kuadrin rregullator të biznesit për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. Studimi u realizua me mbështetjen financiare të Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO), Qeverisë Austriake dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Për më shumë informacion mund të vizitoni www.doingbusiness.org/SEE.

Mbi Grupin e Bankës Botërore

Grupi i Bankës Botërore është një nga burimet më të mëdha në botë për financim dhe njohuri për vendet në zhvillim. Ai përfshin pesë institucione të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin: Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) të cilat së bashku formojnë Bankën Botërore; Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC); Agjencinë për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA) dhe Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID). Secili institucion luan një rol të qartë në misionin për të luftuar varfërinë dhe për të përmirësuar standardet e jetesës për njerëzit në botën në zhvillim. Për më shumë informacion vizitoni www.worldbank.org, www.miga.org, dhe www.ifc.org.